



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I BIZNESIT

**SHPALLJA E APLIKIMEVE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË  
TRETË DOKTORATË NË "SHKENCA EKONOMIKE"**

Bazuar në Urdhërin e Ministres së Arsimit Sportit dhe Rinisë, me Nr. 134 datë 17.03.2022, datë 17.03.2022, me Nr.1453/3 Prot, për riorganizimin e programit të studimit Doktoratë në Shkenca Ekonomike dhe në shkresën e MASR, Nr.610/1, datë 06.02.2025 "Mbi listën e udhëhëqesve në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkenca Ekonomike", për vitin akademik **2024-2025**, Fakulteti i Biznesit shpall aplikimet për studentë doktore si më poshtë:

**A. KRITERET DHE PROJEKTET KËRKIMORE SHKENCORE SIPAS  
DEPARTAMENTEVE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I BIZNESIT

**DEPARTAMENTI I FINANCËS**

**I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e doktoratës në shkencë ekonomike në departamentin e Financës**

- a. Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkencë Ekonomike, profili "Financë Kontabilitet", duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e financës, kontabilitetit ose të përafërta me të.
- b. Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, me notë mesatare të ponderuar 8 e lart (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND).
- c. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një Universitet të huaj, diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- d. Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike ose në fusha të përafërta.
- e. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- f. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor në përputhje me fushat e studimit. Kandidatët duhet të kenë dakortësuar me Udhëheqësit Shkencorë.
- g. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkencë Ekonomike të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- h. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- i. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuuese kërkimore shkencore në një nga fushat e ekonomike ose të përafërta me të.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

- j. Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar.

**II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Financës**

1. Nota mesatare vlerësohet <b>maksimalisht me 40 pikë</b> , duke filluar nga 10 pikë nota 8 (tetë), për cdo 0.1, shtohet 1.6 pikë.	<b>(40 pikë maksimalisht)</b>
2. Qendra e punës	<b>(10 pikë maksimalisht)</b>
a. UAMD Me kohe te plote – 10 pikë	
b. Uamd me kohe te pjesshme – 8 pikë	
c. Universitete të tjera publike FT– 6 pikë	
d. Universitete të tjera publike (PT) dhe jopublike (FT+PT) – 4 pikë	
e. Punonjës të institucioneve kërkimore shkencore – 2 pikë	
3. Fusha e studimeve bachelor dhe master	<b>(10 pikë maksimalisht)</b>
a. Financë dhe Kontabilitet - 10 pikë	
b. Shkenca ekonomike – 5 pikë	
c. Shkenca të përafërta – 1 pikë	
4. Rekomandimet (5 pikë për cdo rekomandim)	<b>0-10 pikë</b>
5. Publikime shkencore dhe pjesëmarrje ne konferenca (3 pikë për cdo aktivitet dhe 7 pikë për cdo botim), maksimalisht 10 pikë	<b>0-10 pikë</b>
6. Eksperienca akademike dhe kërkimore shkencore vlerësohet maksimalisht me 10 pikë, duke filluar nga 4 pikë për 2 vite eksperiencë dhe 2 pikë për cdo vit shtesë -max 5 vite vlerësim	<b>0-10 pikë</b>
7. <u>Vlerësimi i Udhëheqësit</u>	<b>0- 10 pikë</b>
<b>TOTALI</b>	<b>0-100 pikë</b>

**Aplikanti për tu shpallur fitues renditen në rend zbritës sipas pikëve të fituara për cdo project ku kanë aplikuar.**

**III. Projektet kërkimore shkencore në Departamentin e Financës**

Principet e financimit dhe sistemet financiare në lidhje me sigurimet shoqërore, *me drejtues shkencor*

- Prof. Asoc. Shqipe Xhaferri



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

**DEPARTAMENTI I MARKETINGUT**

**I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e doktoratës në shkenca ekonomike në Departamentin e Marketingut**

- a. Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, profili "Marketing", duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në Shkenca Ekonomike, Menaxhim Marketing ose të përafërta me to.
- b. Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND), me notë mesatare te ponderuar 8 e lart.
- c. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- d. Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike, menaxhim marketingut ose në fusha të përafërta.
- e. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjës për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- a. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar me Udhëheqësin Shkencor.
- f. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, profili "Menaxhim Marketing", të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- g. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- h. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike, Menaxhim Marketingut ose të përafërta me to.
- i. Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar. Përfshihen nga ky kriter studentët e ekselencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I BIZNESIT

II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Marketingut

<b>Mesatare Bachelor + Master</b> (max 100 pike, duke filluar nga 20 pike nota 8 (tete), per cdo 0.1, shtohet 4 pike)	<b>Fusha e Studimit</b> (Marketing – 100 pikë, Shkenca Ekonomike 50 pikë, Shkenca të përafërta – 20 pikë)	<b>Staf Akademik me kohe te plote</b> FT-UAMD – 100 pikë, Universitetet të tjera publike dhe jopublike - 50 pikë, Punonjës të institucioneve kërkimore shkencore – 20 pikë	<b>Eksperienca ne mesimdhënie</b> Max 100 duke filluar nga 40 pike për 2 vite eksperiencë dhe 20 pikë për cdo vit shtese – max 5 vite vlerësim.	<b>Publikime Shkencore</b> (Max 100 pike. 10 pike per cdo Aktivitet (5 x 10) dhe 10 pike për cdo botim (5x10)	<b>PROJEKTI</b> (MAX 100 Pike, vleresim i udheheqesit)	<b>TOTALI</b> (Max 600 pikë)
---	--	--	--	--	---	---------------------------------

III. Projektet kërkimore shkencore në departamentin e Marketingut:

- Ndikimi i Marketingut Digjital në përmirësimin e shërbimeve dhe ndërkombëtarizimin e bizneseve në Shqipëri, *me drejtues shkencor*
  - Prof. As. Dr. Blerim Kola
- Teknikat Inovative të Marketingut në Telemedicinë dhe Shëndetin Dixhital, *me drejtues shkencor*
  - Prof. As. Dr. Marsida Krasniqi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

**DEPARTAMENTI I SHKENCAVE EKONOMIKE**

**I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e doktoratës në shkenca ekonomike në Departamentin e Shkencave Ekonomike.**

- a. Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, profili "Shkenca Ekonomike", duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në Shkenca Ekonomike, Ekonomiks ose të përafërta me to.
- b. Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, ose diplomë të nivelit të dytë DIND, me notë mesatare të ponderuar rreth 8. Vlerësimi i aplikantëve do të bëhet sipas procedurës së pikëzimit të miratuar në Departament.
- c. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- d. Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike ose në fusha të përafërta. Sipas natyrës së projekteve do të preferohen aplikantë që kanë eksperiencë të provuar në përpunimin dhe analizën statistikore.
- e. Preferohen kandidatë të cilët shfaqin aftësitë;
  - Të menduarit krijues;
  - Zhvillimi i sensit kritik lidhur me fushën e kërkimit;
  - Lidhjet mes fushave të ndryshme të kërkimit;
  - Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
  - Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit.
- f. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me Udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", ndryshuar me Udhëzimin nr. 20, datë 22.09.2017). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

- g. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar me Udhëheqësin Shkencor.
- h. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- i. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- j. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike, Ekonomiksit ose të përafërta me to.
- k. Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar. Përfshihen nga ky kriter studentët e ekselencës.

**II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Shkencave Ekonomike:**

1. Nota mesatare vlerësohet maksimalisht me 50 pikë, duke filluar nga 0 zero pike nota 5 (pese), per cdo 0.1, shtohet 1 pikë si më poshtë:
    - a. 5 0 pike
    - b. 6 10 pike
    - c. 7 20 pike
    - d. 8 30 pike
    - e. 9 40 pike
    - f. 10 50 pike
  2. Rekomandimet (5 pike per cdo rekomandim) 0-10 pike
  3. Publikime shkencore dhe pjesmarrje ne konferenca (3 pike per cdo aktivitet dhe 5 pike per cdo botim) 0-10 pike
  4. Eksperienca akademike dhe kerkimore shkencore 0-10 pike
  5. Vleresimi i udheheqesit 0-20 pike
  - TOTALI 0-100 pike**
6. Aplikanti per tu shpallur fitues duhet te grumbulloje minimalisht 50 pike

**III. Projektet kërkimore shkencore në departamentin e Shkencave Ekonomike**

- Forcimi i stabilitetit fiskal dhe financiar në kushtet e pasigurive të shtuara, *me drejtues shkencor*
  - Prof. Asoc. Dr. Ela Golemi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

- Ekonomia qarkulluese, modelet e biznesit dhe inovacioni: Elementet kryesore për një tranzicion të qëndrueshëm në ekonominë qarkulluese të Shqipërisë, *me drejtues shkencor*:
  - Prof. As. Dr. Ela Golemi
  - Prof. As. Dr. Llambi Prendi
  - Prof. As. Dr. Alba Ramallari
  
- Globalizimi i ekonomisë kombëtare i lidhur me parametra makroekonomikë, *me drejtues shkencor* :
  - Prof. As. Dr. Llambi Prendi
  - Prof. As. Dr. Alba Ramallari
  - Prof. Dr. Flora Merko
  - Prof. As. Dr. Alma Zisi
  
- Durana zhvillimi i qëndrueshëm socio ekonomik i një zone të re ekonomike, *me drejtues shkencor* :
  - *Prof. Dr. Flora Merko*





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

**DEPARTAMENTI I STATISTIKËS DHE INFORMATIKËS SË ZBATUAR**

- I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e doktoratës në shkencë ekonomike në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së zbatuar:**
- a. Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkencë Ekonomike, profili "Informatika Ekonomike", duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe/ose Master Shkencor në Shkencë Ekonomike, Informatikë Ekonomike ose të përafërta me to.
  - b. Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND), me notë mesatare të ponderuar 8 e lart.
  - c. Në rastet kur aplikanti ka mbi 10 vite akademike të angazhuar si lektor me kohë të plotë në procesin e mësimdhënies, kandidati përjashtohet nga kriteri i mesatares.
  - d. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
  - e. Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike, Informatikës Ekonomike ose në fusha të përafërta.
  - f. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
  - g. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar me Udhëheqësin Shkencor.
  - h. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkencë Ekonomike, profili "Informatika Ekonomike", të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
  - i. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
  - j. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike, Informatika Ekonomike ose të përafërta me to.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

- k. Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar. Përfshihen nga ky kriter studentët e ekselencës.

**II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.**

- a. Diploma e fituar, kriteri (a) **(maksimumi 400 pikë)**
- |  |          |
|--|----------|
| i. Bachelor në Shkenca Ekonomike ose Informatikë e Zbatuar         | 200 pikë |
| ii. Master Shkencor në Shkenca Ekonomike ose Informatikë Ekonomike | 200 pikë |
| iii. Bachelor, programe të përafërta                               | 150 pikë |
| iv. Master Shkencor, programe të përafërta                         | 150 pikë |
- b. Nota mesatare, kriteri (b) **(maksimumi 250 pikë)**
- |                  |          |
|------------------|----------|
| i. 9.51 – 10.00  | 250 pikë |
| ii. 9.01 – 9.50  | 210 pikë |
| iii. 8.51 – 9.00 | 180 pikë |
| iv. 8.00 – 8.50  | 150 pikë |
- c. Njohuri në gjuhë të huaja, kriteri (e) **(maksimumi 200 pikë)**
- |                                   |          |
|-----------------------------------|----------|
| i. Më shumë sesa një gjuhë e huaj | 200 pikë |
| ii. Një gjuhë e huaj              | 150 pikë |
- d. Pjesmarje në konferenca dhe revista shkencore, kriteri (j) **(maksimumi 150 pikë)**
- |                    |          |
|--------------------|----------|
| i. Më shumë sesa 2 | 150 pikë |
| ii. Deri në 2      | 100 pikë |

**2. Projektet kërkimore shkencore në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar**

- Optimizimi i Strategjive të Cmimit përmes Analizës së të dhënave dhe Modelimeve Statistikore, *me drejtues shkencor:*

- Prof. Asoc. Dr. Brunela Trebicka
- Prof.As. Dr. Rezarta Kalaja
- Prof.As.Dr. Marsida Krasniqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I BIZNESIT

## **B. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM**

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm dhe pranohet në kushtet kur nuk ka asnjë mungesë dokumentacioni:

- ✓ Kërkesë e kandidatit drejtuar departamentit ku është atashuar udhëheqësi.
- ✓ CV e kandidatit së bashku me publikimet e tij, të cilët duhet të jenë të dokumentuara.
- ✓ Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave që ka në dorëzim, së bashku me suplementin e notave.
- ✓ Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës.
- ✓ Dy fotografi
- ✓ Dy rekomandime nga personel akademik me titull
- ✓ Dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj (kopje e noterizuar) sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.
- ✓ Projekt propozim për studimet e doktoratës në përputhje me projektet e miratuara
- ✓ Miratimi paraprak i udhëheqësit
- ✓ Deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës.
- ✓ Vërtetim nga qendra e punës që vërteton se kandidati është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- ✓ Mandat pagese për tarifën e aplikimit për konkurim, prej ALL 3000.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

**C. PROCEDURA DHE AFATET E APLIKIMIT**

1. Dokumentacioni duhet të dorëzohet vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën:  
Universiteti 'Aleksandër Moisiu', Durrës, Lagja nr 1, Rruga e Currilave, Durrës.
  - Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi
2. Procedura e përzgjedhjes fillon menjëherë pas përfundimit të afatit të pritjes së aplikimeve dhe zhvillohet në përputhje me rregulloren e programit të studimit.
3. Aplikantët për informacione më të hollësishme mund të drejtohen në Njësitë Bazë/Departamentet përkatëse.

**AFATI I PRANIMIT TË DOKUMENTACIONIT ËSHTË**

**15 SHKURT 2025 DERI 14 MARS 2025.**